

TREGIMI I PEJGAMBERIT

# JUSUF



Özkan Öze  
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT  
JUSUF



Në pamjet që ilustrojnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



**BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHJTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/4**  
**Libra për fëmijë: 349/4**

**Drejtuesi i botimeve:**

Dr. Fatih Kurt

**Koordinatori i botimeve:**

Lokman Arslan

**Analizimi i veprës:**

Hale Şahin

Elif Erdem

**Editor**

Zeynep Ulviye Özkan

**Përktheu**

Florida Kulla

**Redaktor gjuhësor**

Fatjon Cuka

**Ndjekja e botimit**

Uğur Altuntop

**Botimi**

Bapak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

**Kontakt**

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A


06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr



Pejgamberi Jakub kishte dymbëdhjetë djem,  
të cilët jetonin në shtetin e Kenanit.  
Emri i njërit prej djemve ishte Jusuf.  
Jusufi ishte një fëmijë shumë i bukur.  
Një natë pa një ëndërr të habitshme.  
Kur erdhi mëngjesi ia tregoi të atit këtë ëndërr:  
“Pashë se si njëmbëdhjetë yje, dielli dhe hëna u  
përkulën para meje.”  
Pejgamberi Jakub e kishte kuptuar nga kjo ëndërr  
se në të ardhmen Jusufi do të bëhej një person i  
rëndësishëm.  
I tha: “Mos ua trego vëllezërve të tu këtë ëndërr!”  
Sepse ata xhelozoheshin shumë për  
Jusufin.



Mirëpo vëllezërit e tij e mësuan ëndrrën.  
Thanë: "Babai e do Jusufin më shumë se neve."  
Thurën një plan për të shpëtuar nga ai.  
E morën pranë vetes dhe vajtën në një vend të  
vetmuar. Atje kishte një pus.  
Jusufin e hodhën brenda në pus.





Jusufi mbeti aty, brenda pusit  
dhe s'dinte si të dilte nga atje.  
Vëllezërit vajtën te babai i tyre duke qarë.  
I thanë: "Baba, Jusufin e hëngri ujku!"  
Pejgamberi Jakub e kuptoi ç'kishte ndodhur,  
por ç'të bënte.  
Tha: "Tashmë na nevojitet vetëm durim."  
Vetëm Allahut ia shprehu hallin e tij dhe qau me  
ngashërim.

Ndërsa Jusufi në atë kohë ishte i vetëm në pus  
dhe i bënte dua Allahut

Gjithsesi, ç'mund të bënte tjetër atje?

Pas një kohe aty në afërsi ndaloi një karvan.

Teksa karvanxhiu po merrte ujë nga pusi, gjeti  
Jusufin.

Tha: "Sihariq, gjeta një djalë!"

Karvani po shkonte drejt Egjiptit

Edhe Jusufin e dërguan në Egjipt  
dhe e shitën për një çmim minimal.








Ai që e bleu Jusufin ishte veziri i mbretit,  
i cili e solli atë në saraj  
dhe i tha së shoqes: "Kujdesu mirë për të!  
Ndoshta do të jetë i dobishëm për ne..."  
Jusufi që shpëtoi nga pusi nisi të jetojë në saraj.

Dhe koha rrodhi njësoj si lumenjtë, me shushurimë.  
Jusufi u rrit  
Sa më shumë rritej, aq më shumë zbukurohej.  
Sytë nuk kishin parë më të bukur se ai deri atë ditë.  
Jusufi u bë një djalosh shumë i pashëm.  
Kushdo që e shihte një herë, kthehej dhe  
e shihte sërish.  
dhe ai që e shihte, nuk qëndronte dot pa  
e parë sërish.  
Edhe Zulejhaja e admironte Jusufin.  
Ajo e donte shumë, por vërtet shumë.  
Madje ishte e dashuruar me të!





Një ditë, kur nuk ishte veziri në saraj,  
e thirri Jusufin, që të shkonte tek ajo, por  
Jusufi nuk vajti.

Zulejhaja nguli këmbë. Jusufi e refuzoi.

Jusufi nuk donte të bënte gjëra që i kishte  
ndaluar Allahu dhe vrapoi drejt portës për  
t'u arratisur.

Zulejhaja vrapoi pas tij dhe e arriti.

Pikërisht në atë çast veziri hyri në saraj.

Zulejhaja, sapo pa të shoqin, i tha se Jusufi e  
kishte sulmuar.

Pikërisht për këtë Jusufin e futën në burg.

Qëndroi atje për shumë vite.

Allahu i mësoi Jusufit kuptimin e ëndrrave.

Kushdo që shihte një ëndërr, ia tregonte Jusufit

Ato që thoshte Jusufi dilnin një më një.

Jusufi kryente detyrën e peygamberit në burg,

i ftonte njerëzit drejt së drejtës, së mirës dhe së bukurës.

Ai ishte një i dërguar nga të dërguarit që Allahu e kishte zgjedhur mes nesh.

Ishte një peygamber ndër peygamberët!

Një natë mbreti i Egjiptit pa një ëndërr të habitshme.





Në ëndërr kishte parë shtatë kallinj të gjelbër,  
si dhe shtatë kallinj të thatë.

Dhe se shtatë lopë të dobëta po hanin shtatë  
lopë të shëndosha!

Askush nuk dinte se ç'kuptim kishte kjo ëndërr.

I thanë: "Këtë vetëm Jusufi mund ta dijë".

Vajtën në burg e pyetën Pejgamberin Jusuf.

Pejgamberi Jusuf tha: "Në shtet do të ketë shtatë  
vite begati e më pas shtatë vite zi!"

Prandaj i këshilloi të merrnin masat në periudhën e  
begatë.

Mbretit i pëlqyen shumë këto fjalë.  
E nxori Pejgamberin Jusuf nga burgu dhe e bëri ministër Finance.  
Kërkoj nga ai që të merrte masa kundrejt rrezikut të zisë që priste vendin.  
Në të vërtetë pati shtatë vite të bollshme dhe kur erdhi koha e zisë,  
Pejgamberi Jusuf i kishte marrë masat  
Depot e shtetit ishin të mbushura deri në grykë.  
Askush nuk mbeti i uritur.





Në një rënë prej ditëve të zisë,  
vëllezërit e Jusufit erdhën në Egjipt që të merrnin  
ushqim.

Me Pejgamberin Jakub mbeti vetëm Bunjamini.

Bunjamini ishte vëllai i vogël i Jusufit  
dhe nuk ishte si të tjerët

Pejgamberi Jusuf e donte shumë atë.

Kur erdhën vëllezërit e tij,

Pejgamberi Jusuf i njohu.

Por ata nuk e njohën Pejgamberin Jusuf.





Pejgamberi Jusuf u tha vëllezërve që herën tjetër të merrnin edhe vëllain më të vogël me vete e të vinin.

U tha: "Nëse nuk e sillni atë, nuk do të merrni më ushqim nga unë!"

Ata thanë: "Do t'i themi babait tonë!"

Kur vajtën te babai i tyre i thanë: "Baba, tashmë nuk do të na japin ushqim.

Dërgoje edhe vëllain tonë me ne që të marrim ushqim.

Mos u merakos, do të kujdesemi ne për të."



Pejgamberi Jakub nuk donte ta dërgonte Bunjaminin,  
por ishte i detyruar. I bënte dua Allahut për të.  
Sepse Allahu ishte më i mëshirshmi i mbrojtësve.  
Dhe e dërgoi Bunjaminin bashkë me ta.



Pejgamberi Jusuf, kur pa Bunjaminin, e vështroi me dashuri dhe e përqafoi.


I tha: “Unë jam Jusufi.”

I tregoi çdo gjë që kishte ndodhur dhe thuri një plan që Bunjamini të qëndronte atje. Në çantën e tij fshehu një kupë shumë të vyer të mbretit

Mëngjesin tjetër, teksa vëllezërit po niseshin për rrugë,

u kontrolluan çantat

Kur kupa e mbretit doli nga çanta e Bunjaminit, e fajësuan për vjedhje.





Vëllezërit u larguan duke e lënë Bunjaminin atje.

U kthyen te babai i tyre, Pejgamberi Jakub.

Bunjamini qëndroi pranë vëllait të tij të madh.

Pejgamberi Jakub u mjerua, sepse tashmë kish humbur dhe Bunjaminin.

E qara e tepërt i verboi sytë,  
por nuk e humbi shpresën.

Tregoi durim dhe bëri shumë dua ndaj Allahut.

Pas një kohe vëllezërit u kthyen në Egjipt për Bunjaminin.

Dolën përpara Pejgamberit Jusuf dhe kërkuan që ta falte.

Pejgamberi Jusuf u tha: "A ju kujtohet se ç'i keni bërë Jusufit?"

Ata u habitën dhe thanë: "Mos je ti Jusufi?"

Krahas habitës shprehën edhe frikë,  
por ishin shumë të penduar.

I thanë: "Vallahi Allahu të bëri ty më të lartë se ne, në të vërtetë ne ishim fajtorë."





Jusufi i fali ata  
dhe bëri dua që edhe Zoti t'i falte.  
U tha: "Allahu ju faltë! Ai është më i mëshirshmi i  
të mëshirshmëve."  
Më pas hoqi këmishën që kishte veshur dhe ua  
dha atyre.  
U tha: "Merreni këtë këmishë,  
fërkojeni në sytë e babait tim që t'i hapen sytë.  
Më pas ejani bashkë me gjithë familjen."

Ata sapo kishin lënë Egjiptin.  
Pejgamberi Jakub tha: “Ndiej aromën e Jusufit”  
Kur arritën në shtëpi, Pejgamberi Jakub që kishte  
marrë këmishën,  
i mori fort erë dhe e përqafoi.  
E fërkoi në sy e në fytyrë.

Allahu ia hapi sytë sërish.

Më pas vajtën të gjithë në Egjipt, pranë  
Pejgamberit Jusuf.

Kur arritën, Jusufi përqafoi të ëmën  
dhe të atin,  
I përqafoi fort.





Njëmbëdhjetë vëllezërit, e ëma dhe i ati u përkulën me respekt dhe dashuri para Jusufit. Kështu edhe ëndrra që Pejgamberi Jusuf kishte parë para shumë vitesh u realizua... Njëmbëdhjetë yjet ishin vëllezërit e tij, dielli ishte i ati, ndërsa hëna e ëma... Kjo, pra, është historia e Pejgamberit Jusuf, me fytyrë të bukur e zemërmirë. Dhe është historia më e bukur e historive...

